



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

Nr. 24B/1 Prot.

Tiranë, më 20.10.2025

VENDIM

Nr. 311, Datë 10.10.2025

**“PËR MIRATIMIN E VEPRIMTARISË JASHTË FUNKSIONIT TË PROKURORIT
ENI ÇULLI”**

Këshilli i Lartë i Prokurorisë, i përbërë nga:

1. Mirela BOGDANI	Kryetar (në mungesë)
2. Erind GERMENJI	Zv/kryetar
3. Sokol STOJANI	Anëtar
4. Zeqir HODA	Anëtar
5. Arta MANDRO	Anëtar (në mungesë)
6. Ledina RIZA	Anëtar (në mungesë)
7. Moisi DUDA	Anëtar
8. Vatë STAKA	Anëtar
9. Olger EMINAJ	Anëtar
10. Erind MERKURI	Anëtar
11. Erion FEJZULLA	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.10.2025, në përputhje me procedurën e përcaktuar në nenet 159-161, 164 dhe vijues të ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenet 18 e vijues, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të Këshillit të Lartë të Prokurorisë”, shqyrtoi çështjen me objekt:

“Për miratimin e veprimtarisë jashtë funksionit të Prokurorit Eni Çulli”

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË:

Pasi mori në shqyrtim Relacionin shoqërues nr. 2473 prot., datë 06.10.2025, të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, dëgjoi Relatorin Erion Fejzulla, si dhe referuar bazës ligjore të lartpërmendur, përfshirë diskutimet në mbledhje mbi çështjen,

V Ë R E N:

1. Pranë Këshillit është administruar me nr. 2405 prot., datë 24.09.2025 dhe nr. 2405/2 prot., datë 26.09.2025, Kërkesa e magjistratit Eni Çulli, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat, për kryerjen e veprimtarisë jashtë funksioni.
2. Kërkuesi, prokurori Eni Çulli ka parashtruar kërkesën për të qenë pedagog i jashtëm për lëndët “E Drejta Penale” Pjesa e Posaçme” dhe “E Drejta e Procedurës Penale”, si pjesë e programit mësimor në semestrat e parë dhe të dytë, Viti II, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë.
3. Kohëzgjatja e angazhimit do të jetë nga data 06.10.2025 dhe do të përfundojë me përfundimin e vitit akademik, në muajin Qershor 2026.
4. Veprimtaria jashtë funksionit është parashikuar për t’u përmbushur gjatë/jashtë orarit zyrtar të punës për një total prej 4 orësh mësimi në javë të cilat do të zhvillohen vetëm ditën e Premte, në pjesën e dytë të ditës.
5. Pagesa për këtë veprimtari do të jetë në shumën 705 lekë për çdo orë (60 minuta) në përputhje me tarifat e miratuara nga Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 748 datë 11.06.2009 “Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të personelit akademik të institucioneve publike të arsimit të lartë”, i ndryshuar.
6. Bashkëlidhur Kërkesës gjendet informacioni, administruar me nr. 2405/1 prot., datë 24.09.2025, nga Drejtuesi i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat mbi ngarkesën personale të punës së prokurorit, ngarkesë e cila rezulton brenda mesatares të ngarkesës që kanë prokurorët e tjerë të zyrës.
7. Nga shqyrtimi i dokumentacionit, Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit konstaton se, prokurori Eni Çulli nuk është subjekt i ndonjë procedimi disiplinor dhe nuk ka masa disiplinore në fuqi. Njëkohësisht, vlerësohet se kryerja e veprimtarisë jashtë funksionit nga kërkuesi nuk cenon ecurinë e punës në institucion.
8. Në këto kushte, ushtrimi i veprimtarisë jashtë funksionit në masën dhe kohën e kërkuar nuk ndikon negativisht në ushtrimin e detyrës së tij.
9. Veprimtaria jashtë funksionit në rastin konkret:

- është në përputhje me dinjitetin e ushtrimit të funksionit;
- nuk është e papajtueshme me ushtrimin e funksionit të magistratit dhe nuk ndalohet sipas ligjit.
- nuk krijon perceptime të ndikimit ose njëanshmëri gjatë ushtrimit të funksionit;
- nuk bie ndesh me interesat thelbësorë të funksionit, duke mos cenuar afatet dhe ushtrimin në mënyrë efikase të funksioneve.

10. Për sa më sipër, Komisioni i Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit i propozoi Këshillit, miratimin e kërkesës për veprimtari jashtë funksioni, të prokurorit Eni Çulli, si pedagog i jashtëm për lëndët “E Drejta Penale” Pjesa e Posaçme” dhe “E Drejta e Procedurës Penale”, si pjesë e programit mësimor në semestrat e parë dhe të dytë, Viti II, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë.

PËR KËTO ARSYE:

Bazuar në nenet 149/a, pika 1, germa “e” dhe 149/ç, të Kushtetutës të Republikës së Shqipërisë, në nenin 9, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në nenet 164, pika 8, 166 dhe 189, pika 1, germa “a”, të Ligjit nr. 115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe në nenin 8, të Rregullores “Për veprimtaritë jashtë funksionit të prokurorëve”, me propozim të Komisionit të Planifikimit Strategjik, i Administrimit dhe Buxhetit, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

V E N D O S I:

1. Miratimin e veprimtarisë jashtë funksioni për prokurorin Eni Çulli, si pedagog i jashtëm për lëndët “E Drejta Penale” Pjesa e Posaçme” dhe “E Drejta e Procedurës Penale”, si pjesë e programit mësimor në semestrat e parë dhe të dytë, Viti II, Fakulteti i Sigurisë dhe Hetimit, Akademia e Sigurisë.
2. Të njoftohet për këtë vendim Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Berat dhe prokurori Eni Çulli.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit.

U shpall në Tiranë sot më 10.10.2025.

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ZV/KRYETAR
Erind Germenji

ANËTAR
Sokol Stojani

ANËTAR
Zeqir Hoda

ANËTAR
Moisi Duda

ANËTAR
Vatë Staka

ANËTAR
Olger Eminaj

ANËTAR
Erind Merkuri

ANËTAR
Erion Fejzulla

KOPJE WEB